

Testi për COVID-19 aktualisht pritet të marrë të paktën 48 orë për të kthyer rezultatet. Nëse keni një kartelë elektronike MyChart për të dhënat tuaja mjekësore të UMass Memorial, ju mund t'i shihni këto rezultate aty, pasi të jenë gati. Ju lutemi kontaktoni ofruesin e kujdesit shëndetësor nëse keni ndonjë pyetje.

Nëse testi juaj kthehet POZITIV për COVID-19:

- Ne do të njoftojmë Departamentin e Shëndetit Publik të Massachusetts sic jemi të obliguar për të vepruar për monitorimin e shëndetit publik.
- Qëndroni në shtëpi derisa të udhëzoheni që mund të dilni. Pacientët me COVID-19 të konfirmuar duhet të qëndrojnë nën masa paraprake izolimi në shtëpi derisa rreziku i transmetimit sekondar të tjerët mendohet të jetë i ulët.
- Bisedoni me ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor ose zyrtarët e shëndetit publik. Vendimi për të ndërprerë masat paraprake të izolimit në shtëpi duhet të merret rast pas rasti, në konsultim me ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe departamentet shëndetësore shtetërore lokale.

Nëse testi juaj kthehet NEGATIV për COVID-19:

- Vazhdoni izolimin në shtëpi derisa simptomat tuaja të jenë zgjidhur për të paktën **24 orë** dhe të paktën **10 ditë** nga fillimi i simptomave, cilado që të jetë më e gjatë.

Ju lutemi referojuni këtyre udhëzimeve nga Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC): www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/if-you-are-sick/steps-when-sick.html